



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1071 prot.

Pukë, më 24.05. 2022

PROJEKT - VENDIM

Nr. 02 Datë 24.05 2022

PËR DHËNIE TITULLI QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË

Z. Pal Dedë Bajraktari (pas vdekjes)

Këshilli i Bashkisë Pukë në zbatim të Nenit 54, pika "m" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Të nenit 3, pika 1; nenit 14, pika 1; nenit 15, pika 1/a dhe 2; nenit 16, pika 1; nenit 17; nenit 18; nenit 19; nenit 20, pika "ç"; të ligjit nr. 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 113, pika "dh", të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me Propozim të Kryetarit të Bashkisë

VENDOSI

1. T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë, **Z. Pal Dedë Bajraktari (pas vdekjes)** me motivacionin:

"Për kontributin e dhënë si një ndër iniciatorët e parë që deri në fund të jetës së tij do të merrej me zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e gjaqeve , jo vetëm në rrethin e Pukës por dhe në bashki të tjera të veriut ."

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, i ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Drejtor DMBNJ
Emirjona Pergjegjaj

Ne mungese dhe me urdher
Zv.kryetari
Ershefa Gjoni



Jurist
Aida Sinani

KRYETARI
Gjon Gjonaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ prot.

Pukë, më ____ . ____ . 2022

Relacion

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR DHËNIE TITULLI “ QYTETAR NDERI”

Z. Pal Dedë Bajraktari (pas vdekjes)

Mbështetur në ligjin nr. **139/2015** “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin **112/2013**, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (ndryshuar me ligjin nr. **10/2015**, datë **19.2.2015**), pas vlerësimit të kërkesës së bërë për dhënie e titullit qytetar nderi **z. Pal Dedë Bajraktari** me qëllim që të vlerësohet puna dhe kontributi i tij , Këshilli i Bashkisë duke konsideruar propozimin , ju propozon anëtarëve të Këshillit Bashkiak që të vlerësohet figura tij dhe personaliteti, duke ju dhënë titulli i nderit në shenjë respekti dhe mirënjohjeje publike për të gjithë kontributin dhe përkushtimin e tij në fushën e zvogëlimit të fenomenit të gjakmarrjes . Ai u lind me 24.06.1924 , në Bugjon të Pukës, në një familje me vlera patriotike . Nga viti 1945-1952 ka qenë i organizuar në forcat e mbrojtjes nga ku u largua për arsye biografie. Nga viti 1952-1972 ka punuar në ndërmarrjen e përpunimit të drurit Fushë-Arrëz. Në vitet 1972-1980 punoi pranë hidrocentralit të Fierzës. Në vitin 1980 del në pension në kooperativen bujqësore në Bugjon. Pas viteve '90 ai kontribuoi në zvogëlimin e njëres prej plagëve më të mëdha në shoqërinë tonë, gjakmarrjes.

Me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

T'i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Pukë, **z. Pal Dedë Bajraktari (pas vdekjes)** me motivacionin:

“Për kontributin e dhënë si një ndër iniciatorët e parë që deri në fund të jetës së tij do të merrej me zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e gjaqeve , jo vetëm në rrethin e Pukës por dhe në bashki të tjera të veriut .”

Ky titull i jepet në shenjë nderimi dhe vlerësimi për të gjithë punën dhe kontributin e dhënë në fushën e zvogëlimit të fenomenit të gjakmarrjes, **z. Pal Dedë Bajraktari (pas vdekjes)**.

1. Për të gjitha meritat e lartpërmendura propozohet ti akordohet titulli “Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë”

Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Emirjona Pergjegjaj

Pal Ded Bajraktari

Ka lindur me 24 Qershor 1924 ne Bugjon Puke.

U rrit dhe jetoi ne nje familje me vlera patriotike.

Nga viti 1945- 1952 ka qene i organizuar ne forcat e mbrojtjes. U largua nga ushtria per arsye biografie.

Nga viti 1952 -1972 ka punuar ne Ndermarrjen e perpunimit te drurit Fushe Arrez.

Nga viti 1972-1980 Hidrocentrali i Fierzes.

Nga viti 1980 e deri ne daljen ne pension ne kooperativen bujqesore Bugjon.

Rrjedh nga nje familje qe i ka dhene shume Pukes por dhe me gjere.

Gjyshi i tij ish bajraktari i fisit Thaç, ka qene pjesmarres ne Lidhjen Shqiptare te Prizrenit, si dhe nje nga firmetaret e krijimit te Qeverise Provizore ne Kimez te Pukes ne vitin 1911 nen drejtimin e Terenc Toçit.

Ish xhaxhai i tij Mark Frrok Bajraktari eshte dekoruar "Martir i Demokracise" per kontributin e dhene per liri dhe demokraci ne Shqiperi.

Shkolla e Bugjonit mban emrin e njerit prej pinjollve te kesaj familje, Kol Nikoll Bajraktari, ish mesuesi i pare i kesa shkolle.

Si shume familje te medha edhe familja e Pal Ded Bajraktarit perpara viteve 90 ishte ne listen e atyre familjeve qe do te vuante persekucionin nga sistemi i kaluar.

Pas viteve 90, Pal Ded Bajraktari do te ishte nder iniciatorët e pare qe do te kontribonte deri ne fund te jetes se tij ne zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e gjaqeve, nje plage mjat e hapur ne shoqerine tone ne keto vite.

Ai dha nje kontribut mjaft te rendesishem ne kete drejtim duke u bere keshtu udherrefyës i paqes dhe pajtimit per shume familje jo vetem ne rrethin e Pukes por edhe ne Tropoje, Dukagjin, Mirdite e deri ne Kodove.

Me te drejte nje nga gazetaret e ketyre kronikave ne momentin e ndarjes nga jeta te Pal Bajraktarit, do te citonte:

Iku misionari i fundit i paqës, ky Anton Çeta i fundit shqiptar!

Vërtetë edhe përse në kohë moderne, ne Veriu sot kemi humbur mendimtarin e pajtimtarin i cili tashmë shkon në botën tjetër.

Veriu humbi Anton Çetën e fundit.


Per gjate gjithë kohes qe ka ushtruar detyren fisnike te misionarit te pajtimit ka qene nje nga figurat kryesore te Komitetit te Pajtimit te gjaqeve.

Misioni i Pajtimit Mbarekombetar Shqiptar e ka vleresuar me çertefikate mirenjohje per kontribut ne pajtimin dhe zvoglimin e fenomenit te gjakmarrjes.

Gjithashtu Bashkia Kamez, aty ku kaloi dhe vitet e fundit te jetes se tij e ka vleresuar si personalitet me motivacion:

" Per punën e pakursyer, kohën dhe angazhimin kushtuar zhvillimit te qytetit te Kamzës gjate veprimtarise se tij ne dobi te komunitetit, si dhe duke qenë nje model per brezat e rinj".

U nda nga jeta me 21 Maj 2021 duke lene pas nje arkive mjaft te pasur per brezat qe do te vijne.





MISIONI I PAJTIMIT MBAREKOMBETAR SHQIPTAR

CERTIFIKATE MIRËNJOHJE

I jepet **Z. PAL DED BAJRAKTARI**

**PËR KONTRIBUT NË PAJTIMIN DHE
ZVOGËLIMIN E FENOMENIT TË GJAKMARRJES**

SEKRETARI
GJIN GJOLI

TIRANE 2012

KRYETARI
MARK PALNISO

